



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 240, datë 29.12.2021

**MBI
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË AKTIVITETIT TË DEPOZITARIT TË
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE
“TIRANA BANK” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 238, pika 3, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së aktivitetit të depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike “Tirana Bank” sh.a., me kërkesat e Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe rregulloreve në zbatim të tij.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**